



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

LËNDA: GJEOGRAFI E BUJQËSISË

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Edlira KOLA
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	III/I

Përshkrimi: Lënda synon t'i pajisë studentët me njohuritë bazë mbi: bujqësinë, si një ndër veprimtaritë kryesore të ushtruara në hapësirën rurale, ku angazhohet pjesa më e madhe e fuqisë punëtore; tipet e kulturave bujqësore dhe shpërndarjen; ndikimin e faktorëve natyrorë dhe humanë në zhvillimin e bujqësisë; prirjet bashkëkohore të zhvillimit të saj, në shkallë globale dhe lokale.

Temat e leksioneve:

1. Objekti, përmbajtja dhe detyrat e gjeografisë së bujqësisë. Rëndësia e studimit të bujqësisë nga gjeografi dhe specifikat e këndvështrimit të tij.
2. Bujqësia si veprimtari ekonomike kryesore në hapësirën rurale. Vendi i saj në kuadër të ekonomisë rurale dhe ndërlidhja me veprimtaritë e tjera të zhvilluara në hapësirën rurale.
3. Roli i kushteve natyrore në zhvillimin e bujqësisë: relievi, klima, tokat, ujërat, bota bimore dhe bota shtazore.
4. Roli i faktorëve humanë në zhvillimin e bujqësisë: ndikimi i shfrytëzimit të resurseve natyrore, zhvillimit të teknologjisë, administrimit të territorit, ushtrimit të veprimtarive ekonomike jo bujqësore etj.
5. Prona dhe pronarët në ekonominë bujqësore. Tipet e pronave dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e veprimtarisë bujqësore.
6. Njësitë e prodhimit bujqësor. Aspektet bazë të njësive të prodhimit.
7. Aspekte teknike dhe ekonomike të bujqësisë.

8. Bujqësia intensive dhe ekstensive dhe roli i saj në mjedis. Tipet e prodhimit bujqësor.
9. Përhapja gjeografike dhe prodhimi i kulturave bujqësore. Ndikimi i faktorëve natyrorë dhe humanë në shpërndarje.
10. Blegtoria si veprimtari e rëndësishme e ekonomisë bujqësore. Tipet e prodhimit blegtoral.
11. Përhapja gjeografike e gjësë së gjallë dhe prodhimi blegtoral në varësi të faktorëve natyrorë dhe humanë.
12. Zhvillimi i bujqësisë dhe mbrojtja e mjedisit. Problematikat e ndotjes së tokës, shfrytëzimit intensiv, rigjenerimit të resurseve etj.
13. Karakteristikat kryesore të bujqësisë së Shqipërisë gjatë gjysmës së parë të shekullit XX: prapambetja e bujqësisë, shkalla e ulët e mekanizimit dhe problematika e pronësisë mbi tokën.
14. Zhvillimi i bujqësisë në Shqipëri gjatë periudhës 1945-1990. Reforma agrare dhe kolektivizimi në bujqësi. Kriza e viteve '80.
15. Dinamikat bujqësore të Shqipërisë prej fillimit të viteve '90. Zbatimi i Ligjit 7501 "Për tokën" dhe efektet e tij në sistemin e pronësisë dhe në ekonomi. Perspektiva e zhvillimit të bujqësisë.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit:

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. LAÇI S. (2015), *Gjeografia humane e Shqipërisë*. Tiranë : LILO. 339 fq.
2. LAÇI S., KOLA E.; XHAFA S.; LAÇI E. (2014), *Gjeografia rurale*. Tiranë: LILO. 367 fq.

Literatura plotësuese:

1. ARLAUD S., PÉRIGORD, M. (1997), *Dynamique des agricultures et des campagnes dans le monde*. Paris: Ophrys. 248 fq.
2. BONNAMOUR J. (ed.) (1996), *Agricultures et campagnes dans le Monde*. Paris: SEDES. 320 fq.
3. DHILLON S. S. (2004), *Agricultural geography*. New Delhi: Tata McGraw - Hill Education. 492 fq.
4. GRIGG D. (1995), *An introduction to agricultural geography*. New York: Routledge. 236 fq.
5. LEBEAU R. (1986), *Les grands types de structures agraires dans le monde*. Paris: Masson. 170 fq.

6. LESOURD M. (1997), *Crises et mutations des agricultures et des espaces ruraux*. Paris: Ed. du Temps. 160 fq.
7. MERENNE-SCHOUMAKER B. (1999), *La localisation des productions agricoles*. Paris: Nathan Université. 192 fq.
8. ROBINSON G. M. (2003), *Geographies of Agriculture: Globalisation, Restructuring and Sustainability*. Routledge. 2003.